



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:157234
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05721586

Ac.nr.191/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Faton Ademi kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Besnik Bisliraj anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Shpetim Azemi, në çështjen juridike të paditësit Zh.S. nga fsh. ..., Komuna e Ranillukut, të cilin me autorizim e përfaqëson E.A., avokat nga Kamenica, kundër të paditurit J.P. nga fsh. ..., Komuna e Ranillukut, të cilin me autorizim e përfaqëson E.Q., avokat nga Gjilani, për shkak të ekzistimit të së drejtës së kalimit, vlera e kontestit 1,000.00€, duke vendosur sipas ankesës së paditës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.78/2016 të datës 24.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësit Zh.S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.78/2016 të datës 24.09.2020, **PRISHET** dhe çështja i kthehet të njëjtës Gjykatë, në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.78/2016 të datës 24.09.2020, ka vendosur si në vijim:

“I: REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Zh.S. nga fsh..., me të cilën ka kërkuar të vendosin të drejtën e kalimit të përhershëm këmbë, qerre tërheqëse, me traktor dhe mjete të tjera nëpër parceles shërbyese P=1559=5 e regjistruar në emër të J.P. në fsh. ..., Komuna e Ranillukut, në favor të parceles shërbyese të ngastrës P. 1563=0 e regjistruar te Drejtoria Kadastrale në Ranilluk, sipas fletë posedimit nr. 103 në Drejtorinë e Kadastrës në Ranilluk, për Zonën Kadastrale Ropotovë e Madhe në vendin e quajtur " Dvoorishte" e evidentuar në emrin Zh.S., këtu i padituri.

II. OBLIGOHET paditësi Zh.S., që të paditurit J.P. të i kompenzojë shpenzimet e procedurës dhe ate:

Për përgjegje në padi 104 euro

Për pesë seance të mbajtura nga 125.20 euro

Giithësejt: 790 euro, në afat prej 15 ditëve nga dila e plotfuqishmërusë së këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ”

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë kanë parashtruar paditësi përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave kontestimore neni 182 par.1 pika n) të LPK-së, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike neni 183 par.1 i LPK-së, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale neni 184 i LPK-së, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset, dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje apo qëi njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar, duke ju njohur paditësit të gjitha shpenzimet procedurale duke përfshirë edhe shpenzimet e kësaj anese me të cilat obligohet i padituri që ti kompensoj.

Në afat ligjor i padituri përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar, dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë ne dispozitivin I, ndërsa dispozitivi II të ndryshohet sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e Apelit, si Gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitave së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

-Ankesa e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës, vërtetohet se paditësi ka parashtruar padi me datë 07.04.2016, pranë Gjykatës së shkallës së parë për vërtetimin e së drejtës së pronësisë, më konkretisht me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditësit, pas vlerësimit dhe administrimit të provave veç e veç dhe vërtetimit të gjendjes faktike ka marrë aktgjykimin, C.nr.78/2016 të datës 24.09.2020, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka konstatuar se Nuk janë plotësuar kushtet nga neni 252 dhe 253 të Ligjit mbi pronësisën dhe të drejtave tjera sendore nr.03/L-154 për vendosjen e të drejtës së kalimit në interes të ngastres dominuese e cila është pronë e të paditurit. Me dispozitën e nenit 254 të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtave tjera sendore është përshkruar e drejta e servitutit aktual kryhet në një mënyrë që më së paku e ngarkon të mirën shërbyese. Sipas rregullava e drejta e kalimit rregullohet kur pronari në favor të ngastres dominuese në tërësi apo pjesërisht nuk mund ta shfrytëzojnë këtë të mirë pa shfrytëzimin e të miërs shërbyese si dhe rasteve të tjera të caltuara me ligj. Paditësi duke thirrur në fitimin e të drejtës së kalimit, në bazë të parashkrimit është në kundërshtim me nenin 40 të Ligiit mbi pronësinë dhe të drejtave tjera sendore, kurse paditësi në kërkesëpadi thekson kërkesën për fitimin e të së drejtës së kalimit.

Tutje Gjykata e shkallës së parë, ka potencuar se rrethanat se paditësi në tërë gjatësinë prej 19.42 metra, ka ndërtuar murin rrethues me të cilin e ka ndërtuar në favor dominues të ngastres 1563-0 e cila me gjatësinë e njëjtë del në rrugën e asfaltuar publike, nuk mund të jetë shkak për konstituimin e se drtejtës së kalimit në të mirën shërbyese të ngastres nr. 1559-3 Komuna Kadastrale Ropotovë, sepse e drejta e kalimit vendoset kur në pamundësi të shfrytëzimit të ngastres shërbyese ka ardhur pa fajin e personit i cili kërkon të vendoset e drejta e kalimit , përmes shërbimit të mirë fqinjësor. Në rastin konkret e drejta dominuese (ngastra nr.1563-0 KK Ropotovo) ka dalje ne rrugëç në rugën publike të asfaltuar e cila kufizohet ne anën jugore dhe

paditësi me të mirën e tij dominante mund ta shfrytëzojnë pa cfardo shfrytëzimi shërbyes të ngatrs nr. 1559-3. Andaj me këtë është vërtetuar se nuk janë plotësuar kushtet për vendosjen e të drejtës së kalimit, në mënyrë siç është kërkuar me kërkesëpadi.

Vendimin për shpenzimet e procedurës Gjykata e ka marrë konform nenit 452, par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nuk e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) në nenit 182.1 lidhur e nenin 160.4 të LPK-së si dhe lidhur me nenin 99 dhe 102 të LPK-së, gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ku si rezultat i së cilës ka ardhë deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Me nenin 99.1 të LPK-së përcaktohet se: *“Padia, përgjigjja në padi, mjetet e goditjes së vendimit dhe deklaratat e tjera, propozimet dhe njoftimet, që bëhen jashtë seancave gjyqësore, paraqiten me shkrim (parashtrësar). Kushtin e formës së 19 shkruar e përmbushin edhe parashtrësar e dërguara me anë të telegrafit, telefaksit apo postës elektronike. Parashtrësar e këtilla quhen të firmosura , po që se në to është treguar dërguesi.”*

Me nenin 102.1 të LPK-së përcaktohet se: *“Kur një parashtrësar nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, Gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësarën. Në një rrethanë të tillë, Gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësarës.”*

Në rastin konkret nga vendimmarrja e Gjykatës në raport me kërkesën nga padia e paditësit është e pa qartë se paditësi a kërkon konstituim të servitutit mbi bazën e mbajtjes apo vërtetimin e ekzistimit të servitutit sepse këto dallojnë në mes vete, andaj në rrethana të tilla për një padi me kërkesë jo të qartë nuk mund të vendoset në mënyrë meritore por duhet kthyer në përmirësim dhe specifikim përndryshe vendoset në mënyrë procedurale.

Me nenin 182.2 pika të LPK-së përcaktohet se: *“Në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;”*

Me nenin 160.4 të LPK-së përcaktohet se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.”*

Aktgjykimi I atakuar ka shumë të meta si rezultat i të cilave vështirë është i ekzaminueshëm, pasi fillimisht ka një dispozitiv të pa qartë në vetvete të pa plotë dhe të pa përshtatshëm për përmbarrim, pastaj dispozitivi është në kundërshtim me arsyetimin. Arsyetimi i aktgjykimit të atakuar është jo i qartë, nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare ndërsa ato që janë dhënë janë të pa qarta, nuk janë arsyetuar pretendimet e palëve në raport me provat cilave prova u aka fal besimin dhe pse dhe cilave prova nuk u'a ka fal besimin.

Pretendimet me ankesë në raport me vërtetimin jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike qëndrojnë sepse Gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, që i referohet faktit se paditësi a e ka në shfrytëzim për prurje pjesën për të cilën kërkon servitutit, nëse e ka në çfarë periudhe kohore, pastaj ndërtimi i murit të shumë komentuar nga palët dhe Gjykata për cilat arsye e ka bërë dhe në cilën pjesë, a ka ortofot të pronave asaj sunduese dhe asaj shërbyese për të vërtetuar faktin se prona e paditësit a ka pasur qasje përmes pronës së të paditurit sikurse pretendohet. Nuk është vërtetuar fakti se në raport me pronën në të cilën kërkohet servituti i paditurit a e ka kundërshtuar këtë kërkesë, apo a ka paraqitë ndonjë kërkesë në raport me këtë pronë, pra në cilën pjesë saktë të parcelës shtrihet pjesa kontestuese e pretenduar nga pala paditëse, dhe se ajo pjesë a ia pamundëson apo vështirëson shfrytëzimin e pronës të paditurit, përmes cilave prova pala paditëse pretendon t'a vërteton faktin e shfrytëzimit të pronës si servitut etj. Këto janë aspekte që i referohen gjendjes faktike që nuk janë vërtetuar apo janë vërtetuar pjesërisht dhe jo në mënyrë të drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Në raport me të drejtë materiale Gjykata e shkallës së parë përmend dispozitat e Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, ndërsa pretendimi i paditësit është se pronën e të paditurit si servitut e shfrytëzon më tepër se 40 vite, pra si ka mundësi të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore për një raport të krijuar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore.

Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të eliminon shkeljet e konstatuara si më lartë në raport me qartësinë e kërkesës dhe elementet tjera sipas nenit 99, pastaj të vazhdohet tutje të vërtetohet drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendja faktike ashtu që të merren historiatet e pronës së paditësit dhe të paditurit, ortofotot e periudhave kur paditësi pretendon se ka filluar ta ushtroj të drejtën e servitutit, dëgjimin e palëve në cilësi të palëve dhe të dëshmitarëve, të zbatojë drejtë të drejtën materiale duke mos u mjaftuar vetëm me përmendjen e dispozitave pastaj të zbatoj të drejtën materiale në kohën e krijimit të raportit juridik ndërsa me rastin e hartimit të vendimit të sigurohet që vendimi me qenë në përputhje me kërkesat që dalin nga neni 160 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.191/2021, me datë 07.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Faton Ademi, d.v